

VENDIM
Nr. 50, datë 23.11.2022

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN “MBI
MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUAR MBAJTUR NË BANKËN E
SHQIPËRISË NGA BANKAT”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19 dhe nenit 43, shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 29, datë 16.5.2012, i ndryshuar, neni 12/1, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Neni 12/1

Forma e mbajtjes dhe remunerimi i tepricës në llogarinë e rezervës së detyruar

- 1. Bankat mund ta mbajnë tepricën e llogarisë rezervë në lekë dhe në formën cash në kujdestari.*
- 2. Teprica e llogarisë rezervë në lekë është diferenca e gjendjes mesatare në llogarinë rezervë së bashku me cash në kujdestari në periudhën e mbajtjes me rezervën e detyruar të periudhës, por jo më e vogël se niveli minimal i tepricës.*
- 3. Bankat mund ta mbajnë tepricën e llogarisë rezervë në formën cash në kujdestari vetëm pasi të kenë vendosur të paktën nivelin maksimal të përdorimit të rezervës së detyruar në formën cash në kujdestari.*
- 4. Kërkesa e bankës për ta mbajtur tepricën në lekë në formën cash në kujdestari shqyrtohet nga Komiteti i Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare. Komiteti shprehet me vendim në përfundim të shqyrtimit. Në vendim shprehen të paktën: kohëzgjatja, si dhe pjesa e tepricës që do të mbahet në formën cash në kujdestari.*
- 5. Teprica e llogarisë rezervë në euro është diferenca e gjendjes në llogarinë rezervë me rezervën e detyruar të mbajtur në euro, e llogaritur çdo ditë.*
- 6. Teprica e llogarisë rezervë në dollarë amerikanë është diferenca e gjendjes në llogarinë rezervë me rezervën e detyruar të mbajtur në dollarë amerikanë, e llogaritur çdo ditë, por jo më e vogël se niveli minimal i tepricës.*
- 7. Banka e Shqipërisë remuneron tepricën në euro në gjithë shumën e saj. Banka e Shqipërisë remuneron tepricat në llogaritë rezervë në lekë dhe në dollarë amerikanë vetëm në rastet kur tejkalohet niveli minimal i saj, ku si i tillë konsiderohet shuma për të cilën bankat nuk remunerojnë. Si nivel minimal për rezervën e detyruar në lekë dhe USD konsiderohen përkatësisht shumat 50 milionë lekë dhe 500,000.00 USD. Teprica e mbajtur në formën cash në kujdestari nuk është subjekt i remunerimit.*
- 8. Norma e remunerimit të tepricave në llogarinë e rezervës së detyrueshme në lekë, euro dhe USD përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe u komunikohet bankave.*
- 9. Interesi për remunerimin e tepricës llogaritet sipas formulës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 12, të rregullores.”.*
- 2. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.*

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, si dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin në Buletinin Zyrtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko